

VENDIM
Nr.255, datë 5.6.1992

PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMITETIT OLIMPIK SHQIPTAR

Me propozimin e Ministrisë së Kulturës, të Rinisë dhe të Sporteve, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Neni 1

Organizata e Bashkimit të Fiskulturistëve dhe Sportistëve të Shqipërisë, Këshilli i Përgjithshëm dhe Komiteti i tij shpërndahen.

Krijohet Komiteti Olimpik Shqiptar (KOSH), si organizëm olimpik e sportiv kombëtar që mbështetet në parimet e Kartës Olimpike Ndërkombëtare.

Komiteti Olimpik Shqiptar ka selinë në Tiranë dhe e kryen veprimtarinë e vet nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Kulturës, të Rinisë dhe të Sporteve.

Neni 2

Komiteti Olimpik Shqiptar është autoriteti më i lartë i lëvizjes olimpike e sportive kombëtare. Ai është person juridik shtetëror, ka emblemën, vulën dhe stemën e vet. Komiteti Olimpik Shqiptar përbëhet nga deri 25 anëtarë, që zgjidhen me votim të fshehtë nga Asambleja e Përgjithshme e Sporteve. Me përjashtim të Tiranës, komitetet olimpike rajonale, si rregull nuk mund të kenë më shumë se një anëtar në Komitetin Olimpik Shqiptar. Komiteti Olimpik Shqiptar ka presidentin, zëvendëspresidentin dhe sekretarin e përgjithshëm.

Komiteti Olimpik Shqiptar mbledhet 1-2 herë në vit, kurse në raste të veçanta e të domosdoshme ai mund të mbledhet edhe më shpesh. Thirrjen e mbledhjes së tij e bën presidenti i Komitetit Olimpik Shqiptar, duke bërë të ditur edhe rendin e ditës.

Komiteti Olimpik Shqiptar ka këto detyra e të drejta:

- Drejton dhe zhvillon olimpizmin në Shqipëri në përputhje me Kartën Olimpike.
- Bashkëpunin me organizata dhe autoritete publike e private për ta vënë lëvizjen olimpike në shërbim të popullit.
- Lufton kundër të gjitha formave që presin pëmbajtjen e lëvizjes olimpike, dhe mbështet çdo institucion që i përkushtohen edukimit olimpik e sportiv.
- Nuk pranon asnjë lloj abuzimi politik e komercial ndaj sportistëve.
- Mbështet dhe nxit zhvillimin e etikës sportive.
- Mbikëqyr dhe bën përpjekje që fryma e lojës së pëlqyeshme të mbizotërojë kudo në sport.
- Lufton violencën dhe dopingun në sport, në mbrojtje të shëndetit të sportistëve.
- Nxit ngrtjen e Akademisë Olimpike Kombëtare dhe të muzeve olimpike kombëtare e rajonale.
- Miraton rregulloret e funksionimit të komiteteve olimpike rajonale dhe krijimin e komiteteve të reja olimpike rajonale.
- Mban lidhje me Komitetin Olimpik Ndërkombëtar dhe komitetet olimpike kombëtare të vendeve të tjera.
- Nxjerr udhëzime e vendime që kanë të bëjnë me lëvizjen olimpike kombëtare.

Neni 3

Komiteti Olimpik Shqiptar ka të drejtën ekskluzive për të vendosur për përdorimin e emblemës olimpike brenda vendit për qëllime fitimi e reklame, mbi bazën e normave të përcaktuara nga Komiteti Olimpik Ndërkombëtar. Ai drejton e kontrollon veprimtarinë e llotosportit dhe të çdo nisme tjetër që i vjen në ndihmë lëvizjes olimpike dhe asaj sportive.

Neni 4

Organet e Komitetit Olimpik Shqiptar janë:

- Asambleja e Përgjithshme e Sporteve
- Komisioni Ekzekutiv
- Presidenti
- Sekretari i Përgjithshëm
- Federata sportive
- Komitetet olimpike rajonale
- Klubet sportive
- Komisioni i Financës dhe i Kontrollit.

Neni 5

Asambleja e Përgjithshme e Sporteve është mbledhja e zgjeruar e Komitetit Olimpik Shqiptar. Në të bëjnë pjesë presidentët e komiteteve olimpike rajonale, presidentët e klubeve sportive, presidentët dhe sekretarët e federatave sportive. Në asamble bëjnë pjesë edhe presidenti, zv.presidenti dhe sekretari i përgjithshëm i Komitetit Olimpik Shqiptar. Në mbledhjet e asamblesë së përgjithshme të sporteve mund të ftohen personalitete të fushave të ndryshme të sportit, kudrom specialistë e sportistë të dëgjur.

Në sesionin e saj të parë Asambleja zgjedh me votim të drejtpërdrejtë e të fshehtë Komitetin Olimpik Shqiptar, në përputhje me nenin 2 të këtij vendimi. Në këtë sesion Komiteti Olimpik propozon jo më pak se dy kandidtura për presidentin e Komitetit Olimpik Shqiptar dhe zgjedh 10 anëtarë për komisionin ekzekutiv të Komitetit Olimpik Shqiptar.

Në sesion të zakonshëm Asambleja mbledhet një herë në vit, kurse në të jashtëzakonshmin ajo mund të mbledhet me iniciativën e presidentit ose me kërkesën me shkrim që bën të paktën 1/3 e antarëve të saj. Thirrjen e Asamblesë e bën presidenti të paktën 1 muaj përpara, duke njoftuar edhe rendin e ditës.

Neni 6

Asambleja e Përgjithshme e Sporteve ka këto detyra e të drejta:

- Diskuton e miraton raportin vjetor të veprimtarisë së komisionit ekzekutiv të Komitetit Olimpik të Shqipërisë.
- Miraton ndryshimet në KOSH, në përputhje me ndryshimet që pëson Karta Olimpike Ndërkombëtare.
- Merr vendime për probleme që lidhen me rendin e ditës, vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Sporteve janë të vlefshme kur miratohen nga më shumë se 1/2 e anëtarëve të saj.

Neni 7

Funksionet e Komitetit Olimpik Shqiptar, të drejtat dhe detyrat e e tij ndërmjet sesioneve të tij e të Asamblesë së Përgjithshme të Sporteve, i besohen komisionit ekzekutiv prej 11 vetësh, duke përfshirë edhe presidentin. Anëtarë të komisionit ekzekutiv zgjidhen persona drejtues të Komitetit Olimpik Shqiptar, të federatave sportive dhe funksionarë të tjerë të aparatit të tij. Anëtarët e komisionit ekzekutiv zgjidhen për një periudhë 4- vjeçare, por jo më shumë se dy herë radhazi. Në mbledhjen e tij të parë komisioni propozon nga gjiri i tij jo më pak se dy kandidatura përkatësisht për zv.presidentin dhe për sekretar të përgjithshëm të Komitetit Olimpik Shqiptar. Mbledhjet e komisionit ekzekutiv i drejton Presidenti i Komitetit Olimpik Shqiptar.

Në mbledhjen e komisionit ekzekutiv, kur gjykohet e nevojshme, thirren për të marrë pjesë pa të drejtë vote punonjës dhe drejtues të sektoreve të aparatit, të komiteteve olimpike rajonale etj.

Komisioni ekzekutiv ka këto detyra e të drejta:

- Miraton planet dhe programet kryesore të zhvillimit të sporteve dhe kalendarin sportiv kombëtar e ndërkombëtar, sipas propozimeve të federatave sportive që funksionojnë brenda tij, duke i mbështetur ato në treguesit ekonomiko-financiarë që i vihen në dispozicion nga shteti, ose që sigurohen nga veprimtaria sportive e komerciale kombëtare e ndërkombëtare.

- Miraton raportin financiar dhe buxhetin për vitin kalendarik sportiv mbi bazën e strukturës së sporteve dhe ekipeve.
- Organizon, drejton e kontrollon përgatitjen e sportistëve që marrin pjesë në veprimtaritë olimpike e sportive.
- Organizon dhe drejton punën për përgatitjen metodike dhe kualifikimin e sportistëve, të trajnerëve, të gjyqtarëve e të kuadrit drejtues e administrativ të sportit në kudrin e Solidaritetit Olimpik.
- Miraton stimujt e titujt sportivë për trajnerët, gjyqtarët, sportistët dhe kuadrot e sportit.
- Nxist kontributin e shtetasve për anëtarësinë e tyre në klubet sportive dhe federatat kombëtare të sportit.
- Nxist kontributin e sponsorizimeve në ndihmë të lëvizjes sportive.
- Miraton krijimin e federatave të reja kombëtare, të klubeve sportive dhe mbikëqyr veprimtarinë e tyre.
- Nxjerr urdhëra e udhëzime në bazë e për zbatim të dispozitave ligjore në fuqi pret probleme që lidhen me sportet, dhe ushtron kontroll për zbatimin e tyre.

Komisioni ekzekutiv është organ vendimor. Ai mbledhet jo më pak se një herë në muaj. Mbledhjet thirren nga presidenti i Komitetit Olimpik Shqiptar, duke e bërë të njohur më parë rendin e ditës. Vendimet e marra nga komisioni ekzekutiv janë të vlefshme kur miratohen nga më shumë se 1/2 e anëtarëve. Në rast barazie votash, vota e presidentit është vendimtare,

Neni 8

Presidenti i Komitetit Olimpik Shqiptar emrohet nga ministri i Kulturës, i Rinisë dhe i Sporteve, pas propozimit jo më pak se dy kandidaturave nga mbledhja e Komitetit Olimpik Shqiptar. Ministri ruan të drejtën e kthimit të kandidaturave Komitetit Olimpik Shqiptar, nëse gjykon të arsyeshme që personat në fjalë nuk plotësojnë kushtet për të qenë në poste të tilla.

Presidenti zgjidhet dhe emërohet për një periudhë 4-vjeçare jo më shumë se dy herë radhazi.

Duhet të propozohet si president i Komitetit Olimpik Shqiptar një personalitet sportiv që vjen nga një organizatë sportive, institucion sportiv, federatë, komitetet olimpike rajonale etj. Funkcioni i presidentit është i papajtueshëm me çdo funksion tjetër në gjirin e federatave e të komiteteve rajonale dhe me çdo funksion tjetër në gjirin e federatave e të komiteteve olimpike rajonale dhe me çdo funksion partiak e qeveritar.

Deri në mbledhjen më të afërt të Asamblesë funksionet e presidentit i kryen zëvendësi i tij.

Neni 9

Presidenti ka këto detyra e të drejta:

- Drejton veprimtarinë e Asamblesë së Përgjithshme të Komitetit Olimpik Shqiptar e të komisionit ekzekutiv dhe i përfaqëson ato.
- Miraton rregulloren e brendshme të aparatit të Komitetit Olimpik e të sektorëve të tij, të federatave sportive dhe të komisioneve të punës të KOSH.
- Përfaqëson KOSH në të gjitha forumet ndërkombëtare që kanë lidhje me lëvizjen olimpike sportive.
- Miraton krijimin e shoqatave sportive.

Neni 10

Zëvendëspresidenti emrohet nga presidenti i KOSH, pas propozimit jo më pak se dy kandidaturave që zgjedh komisioni ekzekutiv. Zëvendëspresidenti zgjidhet dhe emërohet për një periudhë 4-vjeçare me të drejtë rizgjedhjeje dhe për 4 vjet të tjera. Ai ndihmon presidentin në kryerjen e detyrave dhe e zëvendëson atë të mungesës të tij.

Neni 11

Sekretari i përgjithshëm emërohet nga presidenti i Komitetit Olimpik Shqiptar, pas propozimit të jo më pak se dy kandidaturave nga komisioni ekzekutiv. Sekretari i përgjithshëm ka këto detyra e të drejta:

- Përgjigjet për mbarëvajtjen e punës së personelit të aparatit të Komitetit Olimpik Shqiptar, të komisionit ekzekutiv dhe të komisioneve të specializuara të tij.
- Përgjigjet për anën administrative dhe dokumentacionin e funksionimit të Komitetit Olimpik Shqiptar dhe të komisionit ekzekutiv të tij.
- Përgjigjet për organizimin e mbledhjeve të të gjitha forumeve qendrore të KOSH.
- Dërgon në kohë të gjitha vendimet e udhëzimet që nxjerrin komisioni ekzekutiv dhe forumet e tjera qendrore sportive.

Neni 12

Kontrolli i veprimtarisë ekonomiko-financiare të KOSH dhe të komisionit ekzekutiv ushtrohet nga një komision i përbërë prej 5 anëtarësh (3 efektivë dhe dy të jashtëm). Dy anëtarët efektivë dhe një i jashtëm miratohen përkatësisht nga Ministri i Kulturës, i Rinisë dhe i Sporteve dhe ai i Financave. Dy të tjerët nga presidenti i KOSH.

Të drejtat dhe detyrat e këtij komisioni përcaktohen me rregullore të veçantë që miratohet nga presidenti i Komitetit Olimpik Shqiptar.

Neni 13

Komisioni ekzekutiv i Komitetit Olimpik Shqiptar mbikëqyr veprimtarinë e federatave të mëposhtëme sportive kombëtare:

1. Federata Shqiptare e Atletikës
2. " " e Futbollit
3. " " e Volejbollit
4. " " e Basketbollit
5. " " e Peshëngritjes
6. " " e Qitjes
7. " " e Mundjes
8. " " e çiklizmit
9. " " e Shahut
10. " " e Gjimnastikës
11. " " e Boksit
12. " " e Pingpongut
13. " " e Hendbollit
14. " " e Hipizmit
15. " " e Alpinizmit
16. " " e Notit
17. " " e Skive
18. " " e Tenis-Hokeit
19. " " e Radioamatorizmit

Neni 14

Kryesitë e federatave dhe komisionet ndihmëse të tyre (këshilli qendror i trajnerëve dhe kolegji qendror i gjyqtarëve) janë organizma shoqërore. Ato zgjidhen nga mbledhja e përfqësuesve të sportit përkatës me votim të fshehtë. Kryesitë e federatave, këshillat qendrore të trajnerëve dhe kolegjet qendrore të gjyqtarëve përbëhen nga 5-7 veta. Kryesitë e federatave dhe komisionet ndihmëse të tyre zgjidhen për një periudhë 4-vjeçare, por jo më shumë se dy herë radhazi. Kryesitë e federatave dhe komisionet ndihmëse të tyre punojnë sipas një rregulloreje të brendshme, në përputhje me rregullat e federatave sportive ndërkombëtare dhe të Kartës Olimpike.

Neni 15

Presidenti i federatës zgjidhet nga mbledhja e parë e përfaqësuesve të sportit përkatës. Presidenti mund të zgjidhet një personalitet i sportit përkatës pa kufizim moshe. Zgjedhja e presidentit bëhet me votim të fshehtë. Mandati i presidentit të federatës është për 4 vjet me të dretjë rizgjedhjeje edhe për 4 vjet të tjera.

Të drejtat dhe detyrat e tij përcaktohen me rregulloren e brendshme të federatave sportive.

Neni 16

Sekretarët e federatave emërohen nga presidenti i Komitetit Olimpik Shqiptar, pas propozimit të jo më pak se dy kandidaturave që zgjedh kryesia e federatës.

Neni 17

Këshilli rajonal i sporteve është mbledhja e zgjeruar e komitetit olimpik rajonal për lëvizjen olimpike e sportive. Ai përbëhet nga 30-50 anëtarë që propozohen e zgjidhen nga organet dhe organizatat e specializuara të sportit, ose institucione të tjera sportive të rrethit a të lidhura me to. Këshilli rajonal mbledhet një herë në vit për të bërë analizën e veprimtarisë së tij. Në mbledhjen e tij të parë këshilli rajonal zgjedh komitetin olimpik rajonal në përputhje me neni 18 të këtij vendimi. Në po këtë mbledhje këshilli rajonal propozon nga përberja e komitetit olimpik rajonal jo më pak se dy kandidatura për president të komitetit olimpik rajonal.

Neni 18

Komitetet olimpike rajonale, si organizma sportive, janë autoriteti më i lartë i lëvizjes olimpike dhe i sporteve në shkallë rrethi. Ato janë persona juridikë shtetërorë dhe përbëhen nga 9 veta (presidenti zv.presidenti dhe 7 anëtarë) që zgjidhen nga këshilli rajonal i sporteve. Në komitetin olimpik rajonal zgjidhen personalitete sportive që gëzojnë reputacion të gjerë sportiv në masat sportdashëse të rrethit. Mandati i tyre në këtë komitet është për 4 vjet me të drejtë rizgjedhjeje edhe për 4 vjet të tjera. Në mbledhjen e tij të parë komiteti olimpik rajonal propozon nga gjiri vet jo më pak se dy kandidatura për zv.president të komitetit olimpik rajonal. Miratimin e njërit prej tyre në këtë post e bën presidenti i komitetit olimpik rajonal.

Presidenti i komitetit olimpik rajonal emërohet nga kryesia e komitetit ekzekutiv të rrethit, sipas propozimit jo më pak se dy kandidaturave nga këshilli rajonal i sporteve dhe duke u mbështetur në kriteret e caktuara. Presidenti i komitetit olimpik rajonal është funksionar, detyrat dhe të drejtat e komiteteve olimpike rajonale përcaktohen me rregulloret e tyre që miraton Komiteti Olimpik Shqiptar.

Neni 19

Presidenti i klubit sportiv zgjidhet nga kolektivi punonjës i klubit sportiv, ku bëjnë pjesë të gjithë punonjësit efektivë dhe trajnerët e sporteve që janë në strukturën e klubit sportiv.

Propozohen për president të klubit sportiv jo më pak se dy kandidatura, brenda ose jashtë organikës së klubit sportiv, që plotësojnë kriteret e caktuara. Votimet bëhen të fshehta. Zgjedhja e presidentit bëhet me shumicën absolute të pjesëtarëve në votim.

Neni 20

Vendimet e Këshillit të Ministrave nr.305, datë 22.10.1982, nr.350, datë 18.10.1985, nr.284, datë 15.7.1988, si dhe rregulloret dhe statutet e funksionimit të Komitetit të Këshillit të Përgjithshëm të BFSH-së, shfuqizohen.

Neni 21

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi